



# STUDENTËT E (PA)PËRFAQËSUAR

RAPORT MONITORIMI

Qershor 2024



AUTOR

MATEO YSKOLLARI



## TABELA E PËRMBAJTJES:

<b>1. HYRJE</b> .....	3
<b>2. KËNDVËSHTRIM I PËRGJITHSHËM</b> .....	3
<b>2.1. Përfshirja e Studentëve në organet zgjedhore dhe ato vendimmarrëse</b> .....	4
<b>2.1.1. Universiteti Politeknik i Tiranës</b> .....	5
<b>2.1.2. Universiteti i Tiranës</b> .....	6
<b>2.2. Pjesëmarrja e studentëve në Senatin Akademik</b> .....	7
<b>3. INFORMACION I PËRGJITHSHËM</b> .....	8
<b>4. STUDENTËT PËRBALLË PROCESIT ZGJEDHOR</b> .....	8
<b>4.1. Peshë e votes së studentëve në masën 10%</b> .....	9
<b>4.2. Mosinformimi i studentëve rreth procesit zgjedhor</b> .....	10
<b>5. BURIMET E INFORMACIONIT TË STUDENTËVE PËR ZGJEDHJET E 21 QERSHORIT</b> .....	11
<b>6. PERCEPTIMI I STUDENTËVE LIDHUR ME ORGANET VENDIMMARRËSE</b> 11	
<b>7. NJOHJA E KANDIDATËVE DHE PERFORMANCA E ORGANEVE DREJTUESE</b> .....	
.....12	
<b>7.1. Njohja e kandidatëve për organe drejtuese në universitete</b> .....	12
<b>7.2. Performanca e organeve drejtuese</b> .....	15
<b>8. FUSHATA ZGJEDHORE</b> .....	17
<b>GJETJET</b> .....	20
<b>REKOMANDIME BAZUAR NË GJETJET:</b> .....	20

## 1. HYRJE

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”<sup>1</sup>, i cili parashikon zhvillimin periodik të zgjedhjeve çdo katër vite, Ministria e Arsimit dhe Sportit me anë të urdhërit nr. 101 datë 13.03.2024 shpalli datën 21 Qershor 2024 si datën e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe organet drejtuese në universitetet publike. Në zbatim të këtij urdhëri, studentët dhe personeli akademik i 12 universiteteve publike në vend, ju drejtuan kutive të votimit për të bërë zgjedhjen e tyre.

Ky raport u ndërtua bazuar në të dhënat e mbledhura nga një pyetësor në universitete të ndryshme, duke përfshirë Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Universitetin e Tiranës. Të dhënat janë përpunuar dhe analizuar për të dhënë një pasqyrë të detajuar të perceptimeve dhe qëndrimeve të studentëve ndaj zgjedhjeve universitare dhe organeve vendimmarrëse.

## 2. KËNDVËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Me miratimin e ligjit për arsimin e lartë 80/2015 pesha e votës së studentëve në zgjedhje u ul nga 20% në 10%<sup>2</sup>. Kjo peshë e ulët e votës studentore bën që kandidatët për drejtues në universitete të mos marrin iniciativën e bërjes fushatë me studentët. Në këtë mënyrë interesat studentore mbeten jashtë platformave zgjedhore të kandidatëve për rektor apo dekan.

Ky niveli i ulët i informimit mbi procesin në vetëvete, shoqëruar edhe me faktin që pesha e votës së studentëve është e pakonsiderueshme i dekurajon studentët të votojnë apo edhe të përfaqësohen në organet vendimmarrëse të universitetit, siç është Senati Akademik. Studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në Senat Akademik në

<sup>1</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/Ligji-Arsimit-Larte-Nr-80-2015-1.pdf>

<sup>2</sup> Ligji nr.80/2015 neni 39 pika 2, si edhe neni 42 pika 3

masën 10%, si edhe të kenë përfaqësues në komisionet zgjedhore në rang universiteti dhe fakulteti.

Zgjedhjet në universitete, të zhvilluara katër vjeçarim e shkuar, ishin një tregues i qartë se sistemi arsimor ka nevojë për një reformë thelbësore. Rritja e peshës së votës studentore do të çaktivizonte grupet e krijuara mes akademikëve për të zaptuar postet drjetuese dhe do të krijonte mundësinë e gjithëpërfshirjes në jetën universitare.

## 2.1. Përfshirja e Studentëve në organet zgjedhore dhe ato vendimmarrëse

Pas urdhërit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për shpalljen e datës së zgjedhjeve në Universitete, këto të fundit ngarkohen me detyrën e miratimit të rregulloreve të zgjedhjeve dhe më pas ngritjen e Komisioneve përkatëse për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Administrata zgjedhore në Institucionet e Arsimit të Lartë përbëhet nga:

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ): KIZ përbën organin më të lartë për administrimin e zgjedhjeve në një universitet.

Ky komision përbëhet në çdo rast nga të paktën pesë anëtarë (përbërja është gjithmonë numër tek) të zgjedhur me votë të fshehtë nga Senati Akademik, ku njëri është përfaqësues studentor.

Komisioni i Zgjedhjeve në Fakultete (KZF): KZF përbën organin më të lartë të administrimit zgjedhor në njësinë kryesore. Përbëhet nga një numër tek anëtarësh dhe në çdo rast jo më i vogël se tre anëtarë, ku njëri është përfaqësues studentor


Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV): Krijohet nga KZF për çdo QV kur në njësinë kryesore ka më shumë se një QV. Përbëhet nga një numër tek anëtarësh të vetkandiduar, në çdo rast jo më pak se tre anëtarë, ku njëri është përfaqësues studentor.



Pra, në secilin nivel të administrates zgjedhore në IAL, ka një përfaqësues të studentëve. Nga i gjithë ky process mbetet në hije një nga elementët kryesorë, ai i **kriterit mbi të cilin zgjidhet student i përfaqësues në secilin komision**. Për të treguar gjetjet mbi përfshirjen e studentëve në administratën zgjedhore janë marrë në montorim dy universitete.

### 2.1.1. Universiteti Politeknik i Tiranës

Sipas Vendimit nr.10 datë 28.03.2024<sup>3</sup>, të Senatit Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës për miratimin e rregullores së zgjedhjeve, ky i fundit në mbledhjen e datës 17.05.2024<sup>4</sup>, vendosi konstituimin e Komisionit Institucional Zgjedhor. Në këtë komision u vetëkandiduan 5 studentë nga 14,097 në total të regjistruar në dy ciklet e studimit pranë UPT.



Vendimi nr.11 datë 28.03.2024 Senati Akademik Universiteti i Tiranës

Ky mosinteresim vjen si rezultat i mosinformimit të studentëve me afatet e aplikimit si edhe mungesën e afishimeve të vendimeve në ambientet e Universitetit. Ky komision ndonëse i ngritur me vonesë, për shkak të shtyrejes së mbledhjeve të Senatit Akademik, hapi aplikimet për anëtarë të Senatit Akademik përtej dates së fillimit të procesit zgjedhor, sikundër përcakton urdhëri nr. 101 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Kjo periudhë konstaton jo e favorshme

<sup>3</sup> [Vendimi nr.10 datë 28.03.2024 për miratimin e rregullores së zgjedhjeve UPT.](https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/04/Vendim-Senati-Nr.-10-28.03.2024-miratimi-i-rregullores-se-zgjedhjeve_compressed.pdf)

[https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/04/Vendim-Senati-Nr.-10-28.03.2024-miratimi-i-rregullores-se-zgjedhjeve\\_compressed.pdf](https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/04/Vendim-Senati-Nr.-10-28.03.2024-miratimi-i-rregullores-se-zgjedhjeve_compressed.pdf)

<sup>4</sup> [https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/05/Vendim-Senati-Nr.-17-17.05.2024-KIZ-2024\\_compressed.pdf](https://upt.edu.al/permbajtja/uploads/2024/05/Vendim-Senati-Nr.-17-17.05.2024-KIZ-2024_compressed.pdf)

për studentët për shkak se këta të fundit kishin përfunduar procesin mësimor.

### 2.1.2. Universiteti i Tiranës

Me anë të Vendimit nr. 11 datë 28.03.2024<sup>5</sup> të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, u konfirmuan anëtarët aktualë të KIZ, pasi ishin brenda afatit 4- vjeçar të mandatimit pranë këtij komisioni, duke mos u dhënë kështu mundësia e vetëkandidimit të studentëve për të patur përfaqësi apo alternative të re në nivelin më të lartë të administratës zgjedhore. Në këtë komision përfaqësuese e studentëve mbetet po e njëjta studente, Dhurata Saraçi.

E njëjta situatë për përfaqësimin e studentëve u ndoq edhe në fakultetet e Universitetit të Tiranës për konstituimin e KZF-ve përkatëse. Në 7 fakultete, vetëm në dy prej tyre u bë e mundur vetëkandidimi i studentëve për anëtar të Komisionit Zgjedhor, përkatësisht në:

- Fakulteti i Shkencave të Natyrës (Vendimi nr. 34 datë. 07.05.2024<sup>6</sup>)
- Filiali i UT-së në Sarandë (Vendimi nr.37 datë. 07.05.2024<sup>7</sup>)

Konstituimi i KIZ dhe KZF me po të njëjtit përfaqësues të studentëve rezulton në humbjen e interesit të këtyre të fundit për t'u përfaqësuar e për të shprehur interesin e tyre lidhur me përfshirjen në këto komisione. Ky mosgarantim i të drejtës për t'u përfshirë në strukturat zgjedhore ndikon drejtpërdrejt dhe në ecurinë e vetë procesit zgjedhor, por edhe në demokratizimin e këtij të fundit.

<sup>5</sup> Vendimit nr. 11 datë 28.03.2024 për listen e kandidatëve student për Senatin Akademik UT

<sup>6</sup> Vendimi nr. 34 datë. 07.05.2024 për hapjen e vendit vakant për student në Komisionin Zgjedhor të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (<https://unitir.edu.al/vendime-kiz/>)

<sup>7</sup> Vendimi nr.37 datë. 07.05.2024 për hapjen e vendit vakant për student në Komisionin Zgjedhor të filialit të UT Sarandë (<https://unitir.edu.al/vendime-kiz/>)



## 2.2. Pjesëmarrja e studentëve në Senatin Akademik

1.	Arbi	Iir	Shima
2.	Besi	Teki	Bilaca
3.	Desada	Myflar	Xhetani
4.	Dionis	Tonin	Marku
5.	Ergys	Përparim	Hafilaj
6.	Helena	Edison	Kace
7.	Iva	Vajsi	Barjamaj
8.	Kamelisa	Fejzo	Selami
9.	Kristian	Niko	Nela
10.	Lorenzo	Luan	Sina
11.	Mariza	Fatos	Tola
12.	Melisa	Kazafer	Rama
13.	Orkid	Iir	Mustafaj
14.	Tea	Dritan	Gjonaj
15.	Teojorg	Toni	Gogu

*Kandidatët e regjistruar studentë për Senatin Akademik UT*

Vendimi Nr. 45, Datë 10.05.2024<sup>8</sup>, i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve në Universitetin e Tiranës hapi aplikimet për autoritetet drejtuese, ndër ta edhe për përfaqësues të studentëve në Senatin Akademik. Mbështetur në rregulloren e

zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës si edhe atij Politeknik, studentët kandidatë për Senatin Akademik duhet të përmushin kriteret e përcaktuara, ndër to kërkohej mesatare e ponderuar deri në momentin e aplikimit >8.0.

Universiteti i Tiranës pati 15 studentë të interesuar për Senatin Akademik. Pas verifikimit të dokumentacionit, KIZ miratoi 11 nga 15 Studentë kandidatë për Senatin Akademik.

3. Të regjistrojë kandidatët për anëtarë të Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve si më poshtë:

- Erlini Qordja FIN
- Ervin Stena FIN
- Klandis Qëndro FIN
- Marin Malotaj FIN
- Alesja Bakijasi FTI

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 4, Tiranë, Të/Fax: 00355 4 2227914, web: www.upt.al

- Altea Kënuti FTI
- Roland Çoku FTI
- Realdo Malaj FAU

*Kandidatët e regjistruar studentë për Senatin Akademik UPT*

studentëve kanë interes për t'u përfaqësuar në organin më të lartë

Në Universitetin Politeknik të Tiranës numri i studentëve të interesuar ishte më i ulët. Në këtë Universitet u regjistruan 8 nga 9 kandidatë përfaqësues të studentëve në Senatin Akademik.


Këto shifra tregojnë se vetëm një pjesë shumë e vogël e

<sup>8</sup> <https://unitir.edu.al/vendime-kiz/>

vendimmarrës në Universitete. Këta të fundit nuk janë të informuar mbi hierarkinë vendimmarrëse, ose janë të bindur se zëri i tyre nuk dëgjohej, duke injoruar në këtë formë përfshirjen e tyre në këto struktura.

### 3. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në cilin universitet publik jeni duke kryer studimet tuaja?




Perceptimin e studentëve për zgjedhjet e kemi analizuar nëpërmjet një pyetësi në të cilin morën pjesë

303 studentë kemi analizuar pjesëmarrjen dhe informimin e tyre nga dymbëdhjetë universitete publike, nga të cilat 32.7% të anketuar i përkasin Universitetit të Tiranës, 20.5% Universitetit Politeknik të Tiranës, 27.7% nga Universiteti i Mjekësisë, 10.2% studentë nga Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër dhe 7.3% nga Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë.

### 4. STUDENTËT PËRBALLË PROCESIT ZGJEDHOR

Të pyetur se a do të marrin pjesë në zgjedhjet e datës 21 Qershor, vetëm 12.9% e studentëve të pyetur shprehen se nuk do të marrin pjesë në votime. Ky rezultat tregon interesimin e studentëve për tu përfaqësuar në organet vendimmarrëse.


A do të merrni pjesë në ditën e votimeve?





Në vijim janë marrë në monitorim dy universitete me numrin më të madh të studentëve të regjistruar, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës. Nga analiza e të dhënave të grumbulluara, janë shqyrtuar disa pika delikate si pesha e studentëve, informimi i tyre mbi procesin zgjedhor, pjesëmarrja e tyre në votime si edhe përfshirja në organet vendimmarrëse.

#### 4.1. Pesha e votes së studentëve në masën 10%



*Burimi: Fletorja Zyrtare*

Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë, Senati Akademik është organi më i lartë vendimmarrës brenda univeristetit, i cili përbëhet nga përfaqësues nga rradhët e personelit akademik, si edhe përfaqësues të studentëve. Ky ligj ju njeh studentëve peshën e votws 10%, e ndërkohë personelit akademik peshën në masën 90% <sup>9</sup>. Kjo


pabarazi mbetet një aspekt shqetësues, i cili heq mundësinë e zhvillimit të një procesi parimor e demokratik në zgjedhjen e organeve drejtuese.

Në Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës nga 37 vende që ka në total, 33 anëtarë i përkasin rradhëve të stafit akademik, ndërsa vetëm 4 anëtarë janë përfaqësues të studentëve.

Nëse marrim në konsideratë këtë proporcion, pjesëmarrja e studentëve në Senatin Akademik përkon konkretisht me një raport, ku për 9 pedagogë në organin vendimmarrës të universitetit kemi vetëm 1 përfaqësues nga studentët. Kjo përlllogaritje konsiderohet rrezik për miratimet e vendimeve të cilat prekin direkt apo në rrugë të tërthortë interesat studentore, dhe rrjedhimisht duke ulur interesimin e studentëve për të marrë pjesë në zgjedhje.

<sup>9</sup> Ligji nr.80/2015 neni 39 pika 2, si edhe neni 42 pika 3

Cila mendon se duhet të ishte pesha e votës së studentëve në zgjedhjen e organeve drejtuese?




Të pyetur se sa duhet të ishte pesha e votës në zgjedhjen e organeve drejtuese 85% e studentëve mendojnë se pesha duhet të rritet më shumë se 10% ndërkohë 15% shprehen

se pesha aktuale prej 10% është në nivelin e duhur.

#### 4.2. Mosinformimi i studentëve rreth procesit zgjedhor

Në cilën datë do të zhvillohen zgjedhjet në universitet?



Zgjedhjet për autoritetet (Rektor, Dekan, Përgjegjës departamenti) dhe organet drejtuese (senati akademik) janë ngjarja më e madhe e demokracisë funksionale dhe


përfaqësuese në universitetet publike. Pavarësisht rëndësisë së tyre ka një mungesë të theksuar informacioni, qoftë lidhur me vetë procesin zgjedhor apo përfshirjen e studentëve në të, por edhe me vënien në dijeni të vendimeve, urdhërave apo proceseve të tjera të studentëve.

Është shqetësues fakti se ende 20.1% nuk kanë dijeni lidhur me datën e zhvillimit të zgjedhjeve, atë të 21 Qershorit 2024. Por akoma më shqetësues mbetet mosinformimi i këtyre të fundit nga sekretariteti e Universitetit, nëpërmjet email-eve apo afishimit në abjentet përkatëse të universitetit.

Të pyetur mbi rrugën e informimit lidhur me zgjedhjet e 21 Qershorit, 56.4% e studentëve shprehen se janë informuar nga studentët e tjere, 35% nga rrjetet sociale dhe vetëm 4% shprehen se janë informuar nga sekretaria e Universitetit.



### Si jeni informuar që në universitetin tuaj do të zhvillohen zgjedhje?




Fakti se një pjesë e madhe e studentëve më së shumti informohen nga studentët e tjerë dhe rrjetet sociale, është një tregues se ky

informacion nuk vjen i strukturuar nga organet e universitetit. Për më tepër informacione të tilla që komunikohen në rrugë informale vijnë me gabime, dhe kjo është arsyeja se pse 1 në 5 studentë nuk ka informacion rreth datës së zhvillimit të zgjedhjeve në universitete. Universitetet pavarësisht publikimit në faqet zyrtare web, nuk duhet t'i shmangen informimit të drejtpërdrejtë të studentëve pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk interesohen mbi qasjen në web-et e universiteteve apo e kanë të vështirë të aksesojnë vendimet në to.

### 5. BURIMET E INFORMACIONIT TË STUDENTËVE PËR ZGJEDHJET E 21 QERSHORIT

Nga ana tjetër studentët nuk janë të informuar edhe mbi organet të cilat ata do të votojnë në ditën e votimit. Një pjesë e tyre shprehet se do të votojë për Këshillat Studentore, shefat e departamentit, apo edhe bordin e administrimit.

Në këto zgjedhje do të votohen dhe zgjidhen:




Nga rezultatet e pyetësorit 56.6% apo 169 studentë nga 303 të pyetur janë shprehur se në këto zgjedhje do të votohet edhe për anëtarë të

Këshillave Studentore të cilat nuk janë pjesë e këtyre zgjedhjeve, kurse rreth 7% e studentëve shprehen se në zgjedhjet e 21 Qershorit do të zgjidhen Bordi i Administrimit dhe Administratori i Universitetit të cilat janë organe që emërohen dhe nuk kalojnë asnjëherë në procese zgjedhore.

## 6. PERCEPTIMI I STUDENTËVE LIDHUR ME ORGANET VENDIMMARRËSE

Cili është organi më i lartë vendimmarrës në universitet?



Referuar pyetësorit të përgatitur rezultoi se 62.7% e studentëve të anketuar shprehen që organi më i lartë vendimmarrës në Universitet është Rektori, dhe vetëm

10.6% e tyre janë në dijeni mbi kompetencat e Senatit Akademik. Këto rezultate janë një tregues se shumica e studentëve e shohin Rektorin si autoritetin më të lartë vendimmarrës në universitet.

Mospërgjegjshmëria e organeve kompetente lidhur me informimin e studentëve për sa i përket strukturave të IAL-ve dhe përfshirjen e tyre në organet vendimmarrëse si edhe edukimi demokratik të studentëve mbetet i nevojshëm në universitete.

Nga ana tjetër këto rezultate sjellin në vëmendje mungesën e informacionit nga strukturat që merren me studentët të cilat duhet të bëjnë punë informuese për të njohur organet përfaqësuese si edhe për të arritur njohjen e studentëve me organin vendimmarrës, Senatin Akademik.

## 7. NJOHJA E KANDIDATËVE DHE PERFORMANCA E ORGANEVE DREJTUESE.

Universitete në përditshmërinë e tyre e kanë detyrim transparencën mbi informimin periodik të studentëve. Ky informim duhet të vijë edhe




në qasjen e vetë detyrave të cilat kryejnë organet drejtuese të universitetit aq më tepër organizmave që kanë lidhje direkte me studentët siç janë, Dekani, Senati Akademik dhe Rektori. Kandidatët për poste drejtuese në platformat e tyre duhet të përfshijnë interesat e studentëve, duke ardhur tek ta me tryeza diskutimi dhe më pas me anë të fushatave zgjedhore.

### 7.1. Njohja e kandidatëve për organe drejtuese në universitete

Shumica e Institucioneve të Arsimit të Lartë në rutinën e tyre janë mësuar të shfaqen si institucionet ku shumëçka shkon brenda kornizave aq më tepër mbi transparencën dhe njohjen me studentët, **por sa i njohin vërtetë studentët këta të fundit?**


A keni informacion cilët janë kandidatët për Rektor në universitetin tuaj?



Nga të dhënat e pyetësorit, është e qartë që një numër i konsiderueshëm studentësh 43.2% nuk janë të informuar mbi kandidatët për Rektor. Kjo tregon mungesën e shpërndarjes së informacionit brenda universitetit.

Njohuritë e pjesëshme të 18.2% të studentëve të pyetur tregojnë që disa informacione janë të aksesueshme, por jo mjaftueshëm të detajuara ose të qarta për të dhënë një pamje të plotë për të gjithë kandidatët, duke bërë që studentët të mbeten të shkëputur nga informacionet zgjedhore.


### A keni informacion cilët janë kandidatët për dekan në fakultetin tuaj?



Kjo mungesë informacioni pasqyrohet edhe më tepër në organin që është më afër studentëve, Dekani. Rezultatet e pyetësorit tregojnë se shumica e studentëve 49,5% nuk kanë informacion për kandidatët për Dekan, që përbën një pjesë të konsiderueshme. Kjo identifikon një mungesë të dukshme të komunikimit brenda fakultetit. Fakti se 35% të studentëve janë të informuar për kandidatët është pozitiv, por tregon se informacioni nuk arrin tek të gjithë studentët.

Këto rezultate tregojnë një nevojë urgjente për përmirësimin e strategjive të fushatave zgjedhore brenda fakultetit për të siguruar njohjen te studentët. Për më tepër, këto rezultate vijnë si pasojë e mungesës së organizimit të forumeve të hapura, ku kandidatët prezantojnë veten dhe platformat e tyre ndihmuar në informimin e studentëve dhe në rritjen e transparencës së procesit zgjedhor.

### A keni informacion cilët janë studentët që garojnë për anëtarë të senatit akademik?






Sa i përket njohjes së studentëve kandidatë për Senatit Akademik qasja është më pozitive. Rezultatet tregojnë se 46.9% e studentëve të pyetur janë të informuar për kandidatët përfaqësues të studentëve, e cila është një shenjë e transparencës dhe angazhimit të studentëve brenda universitetit dhe se informacioni rreth kandidatëve është shpërndarë mirë dhe kandidatët janë angazhuar me procesin zgjedhor nëpërmjet fushatës.

Rezultatet e njohjes së kandidatëve studentë janë më të larta në krahasim me kandidaturat për rektor dhe dekan. Një numër i lartë studentësh janë të informuar për kandidatët për anëtarë të senatit akademik në rradhët e studentëve, numër i cili është më e lartë se në të dy kategoritë e mëparshme.

Nga ana tjetër sa i përket njohjes së organeve drejtuese emri i Rektorit njihet më tepër në aspektin piramidal të hierarkisë ndërkohë që studentët duhet të njohin më tepër Dekanin e fakultetit ku studiojnë duke qenë se ky i fundit ka një lidhje më të drejtpërdrejtë me ta.

Gjithashtu kandidatët e studentëve në universitete kanë bërë një punë të mirë për të ardhur nëpërmjet fushatës zgjedhore të studentët e tjerë, ndryshe nga dy kategoritë e para që garojnë në datën 21 Qershor.

#### Mendoni se studentët anëtarë të senatit akademik do të sjellin ndryshimin e standarteve në universitetin tuaj?




Interesant mbetet fakti se, edhe pse studentët do të marrin pjesë në votime dhe i njohin kandidatët studentë, besimi se këta të fundit do të sjellin ndryshim është i ulët ku vetëm 35% e 303 studentëve të pyetur

janë shprehur se kandidatët student do të sjellin risi në standartet e universitetit, pjesa tjetër ka një qëndrim skeptik.

## 7.2. Performanca e organeve drejtuese.

Në vijim është bërë një analizë e performances së organeve drejtuese aktuale, rektorit, dekanit, dhe studentëve në Senatin Akademik.



Nga rezultatet e marra nëpërmjet pyetësorit, 1 në 5 studentë, ose 20 % e studentëve mendojnë se rektori ka bërë punë të mirë apo shumë të mirë në universitetin që ai drejton.

38,7% e vlerësojnë punën e dekanit në fakultetet e tyre ndërsa 23,8 % e studentëve të pyetur mendojnë se anëtarët, përfaqësues të studentëve kanë bërë punë të mirë, ndërkohë që për këtë kategori rritet ndjeshëm numri i studentëve të cilët nuk e vlerësojnë punën e përfaqësuesëve studentë në Senatin Akademik. Përqindja e pjesëmarrësve që kanë dhënë vlerësimin më të ulët (1) është dy herë më e lartë për Rektoren (22.1%) në krahasim me Dekanin (10.9%). Këto rezultate reflektojnë perceptime të ndryshme të pjesëmarrësve për rolin dhe performancën e këtyre dy organeve në universitet.


Lidhur me përfaqësuesit e studentëve në Senatet akademike, nga rezultatet kuptohet se këta të fundit nuk kanë ndjekur platformat dhe premtimet e dhëna e si rrjedhojë nuk kanë përfaqësuar interes të studentëve në organin më të lartë vendimmarrës duke u vlerësuar për punë më të dobët se rektori dhe dekani. Ndonëse kjo ka sjellë uljen e



interesit të studentëve për të kandiduar në Senatet Akademike, por edhe mundësinë që drejtuesit e universiteteve të interesohen mbi problemet e studentëve, duke i bërë pjesë të punës dhe platformave të tyre. **Vlerësimet e ulëta (1 dhe 2) për përfaqësuesit e studentëve përbëjnë 47,5%, të ngjashme me ato të Rektorit (42%), por më të larta se ato për Dekanin (26.4%).**

Nga performanca e organeve drejtuese, studentët janë shprehur se nga 3 organet e pyetura dekani vlerësohet për punën më të mirë krahasuar me rektorin dhe studentët në Senatin Akademik. Kjo vjen si rezultat i faktit se dekani i fakultetit në këndvështrimin e studentëve është organi më pranë tyre, kjo i ka bërë ata që sikur u analizua edhe më sipër të mendojnë se ky organ ka edhe kompetenca vendimmarrëse në Universitet.

### A besoni se zgjedhjet do të sjellin ndryshim në universitetin tuaj?



Në krahasim të rezultateve rektor-dekan studentët janë më kritikë ndaj punës së rektorit duke e vlerësuar atë për një punë më pak të mirë se dekani i fakultetit. Ky vlerësim bën që studentët të mendojnë se edhe kandidatët aktualë të senatit akademik do ndjekin të njëjtën procedure pune, duke e përdorur kandidimin si një aset të shtuar në CV e tyre, por jo për të përfaqësuar zërin e studentëve të cilët do ti votojnë.

Nga rezultatet e pyetësorit si pasojë e performancës së organeve drejtuese aktuale të analizuar më sipër vihet re se 41.2% e studentëve

nuk besojnë se zgjedhjet në universitete do të sjellin ndryshim. Kjo tregon një nivel të lartë të mosbesimit ndaj organeve drejtuese dhe janë pesimistë ose skeptikë ndaj procesit të zgjedhjeve dhe ndikimit të tyre. Mungesa e transparencës në proceset zgjedhore, e ndryshimeve të dukshme pas zgjedhjeve të mëparshme, ose një ndjenjë e mungesës së fuqisë së studentëve për të ndikuar në vendime të rëndësishme të universitetit i bën ata të mendojnë se zgjedhjet e 21 Qershorit nuk do të sjellin ndryshime konkrete.

Nga na tjetër, 29.4% e studentëve ka një qëndrim të neutral, ku ata as nuk janë tërësisht pesimistë, as tërësisht optimistë që përkon edhe me numrin e studentëve të cilët kanë besim në këto zgjedhje.

## 8. FUSHATA ZGJEDHORE

Procesi zgjedhor sipas urdherit të MAS<sup>10</sup> nisi në datën 21.05.2024, datë e cila përkon edhe me nisjen e periudhës së Fushatës Zgjedhore. Në një pjesë të mirë të universiteteve kjo periudhë ishte në disfavor të studentëve, për shkak të mbylljes së procesit mësimor dhe mosprezencës së tyre në auditore. Kjo periudhë pengoi studentët kandidatë për Senatin Akademik të zhvillonin një fushatë intensive në auditore duke i shtyrë ata drejt një mënyre alternative, rrjeteve sociale.

### PLATFORMA ZGJEDHORE

KANDIDATËT E FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFOMACIONIT PËR  
PËRFAQËSUES NË SENATIN AKADEMIK TË  
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

STD. ALTEA KËNUTI  
STD. ROLAND ÇOKU  
STD. ALESJA BAKIASI

*Platforma Zgjedhore e Kandidatëve studentë për  
Senatin Akademik UPT*

zgjedhore as nëpërmjet rrjeteve sociale.

Në Univeristetin e Tiranës një pjesë e studentëve kandidatë e nisën fushatën zgjedhore dhe shpалosjen e programeve të tyre zgjedhore përpara periudhës së përcaktuar, ndërkohë që pjesa tjetër nuk zhvilluan fushatë


<sup>10</sup> Urdhëri nr.101 datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë"



Në Univeristetin Politeknik të Tiranës fushata zgjedhore nisi me vonë se afati i përcaktuar, për shkak të vonesës në konstituimin e Komisionit Institucional Zgjedhor. Vetëm 3<sup>11</sup> nga 8 studentë kandidatë për senatin akademik në këtë universitet zhvilluan fushatë zgjedhore nëpërmjet rrjeteve sociale dhe posterave të shpërndara në ambientet e universitetit.

Paralelisht kandidatët për rektor, dekan dhe Senat Akademik në këto universitete nuk kanë zhvilluar fushatën zgjedhore me studentë, duke mos përfshirë kështu intertesat e tyre në platformat zgjedhore të

### A keni qënë pjesë e ndonjë takimi informues të organizuar nga kandidatët për ogranet drejtuese dhe përfaqësuese?



kandidimit. Të pyetur se a kanë qënë pjesë e ndonjë takimi informues të organizuar nga kandidatët për ogranet drejtuese dhe përfaqësuese, 75.3% e studentëve shprehen se nuk kanë qënë pjesë e takimeve informuese apo nuk kanë qënë në dijeni të organizimit të tyre.

Kjo tregon se shumica e informacionit për kandidatët vjen në rrugë informale, dhe ka mungesë takimesh, tryezash apo diskutimesh për t'i hapur rrugën një precesi demokratik zgjedhor.

<sup>11</sup> Platforma Zgjedhore e tre kandidatëve të UPT (<https://scanned.page/p/666f06eb67f76>)

### GJETJET:

1. Pavarësisht përpjekjeve të bëra nga studentët ndër vite, përfshirja dhe pjesëmarrja e tyre në vendimmarrjen e Universiteteve vazhdon të mbetet e ulët.
2. 20.1% e studentëve nuk janë të informuar për zgjedhjet në universitete si pasojë e mungesës së informimit nga organet e universitetit.
3. Rrjetet sociale dhe studentët e tjerë janë burimet kryesore të informacionit për zgjedhjet, duke theksuar rolin e rëndësishëm të komunikimit jozyrtar.
4. Studentët kanë një mungesë të theksuar informacioni të hierarkisë në universitete dhe njohjes së organit vendimmarrës, 67.2% e tyre identifikojnë rektorin si organin më të lartë vendimmarrës në universitet.
5. 65% e studentëve nuk besojnë se zgjedhjet në universitete do të sjellin ndryshim në IAL-të në Republikën e Shqipërisë, kjo i bën studentët të mos marrin iniciativë për t'u përfshirë në organet vendimmarrëse duke lënë hapësira për konkurrencë të ulët në universitete.
6. Në Universitetin Politeknik të Tiranës kandidatët për rektor dhe dekan nuk kanë organizuar takime zyrtare informuese me studentët për të shpalosur platformat e tyre zgjedhore.



7. Në Universitetin e Tiranës nuk u hapën aplikime për përfshirjen e studentëve në organet zgjedhore duke mos sjellë alternative të re studentore dhe duke ulur frymën e përfshirjes së studentëve.
8. Puna e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik është vlerësuar më kritike krahasuar me Rektorin dhe Dekanin, me 47.5% të vlerësimeve shumë të ulëta dhe një përqindje më të ulët të vlerësimeve të larta.
9. Dekani i fakultetit është vlerësuar si organi me punën më të mire nga studentët.

### REKOMANDIME BAZUAR NË GJETJET:

1. Universitetet dhe organizatat studentore duhet të përmirësojnë shpërndarjen e informacionit mbi zgjedhjet dhe kandidatët përmes platformave të ndryshme, duke përfshirë rrjetet sociale, posterat elektronike, si edhe faqet zyrtare të internetit.
2. Fushata ndërgjegjësuere dhe aktivitete që rrisin angazhimin e studentëve në procesin zgjedhor janë të nevojshme për të rritur pjesëmarrjen dhe për të siguruar një përfaqësim më të mirë.
3. Duhet të ndërmerren përpjekje për të edukuar studentët mbi strukturën e organeve të universitetit dhe rolin e tyre në vendimmarrje për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen.
4. Kandidatët duhet të organizojnë takime informuese dhe debate për të prezantuar platformat e tyre dhe për të rritur njohjen e studentëve me kandidatët dhe programet përkatëse.
5. Universitetet duhet të punojnë për të rritur besimin e studentëve në procesin zgjedhor dhe për të siguruar që zgjedhjet të sjellin ndryshime reale dhe të dukshme në universitet.
6. Universitetet duhet të inkurajojnë pjesëmarrjen e studentëve në zgjedhje përmes fushatave ndërgjegjësuere dhe aktiviteteve që rrisin angazhimin.



#QËNDRESË  MIRËQEVERISJE